



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 18. 10. 2019

VENDIM

Nr. 48, datë 18. 10.2019

"MIRATIMI I TË DHËNAVE TË DRAFT- RAPORTIT, PËR VITIN AKADEMIK 2018- 2019, TË VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në zbatim të nenit 32, nenit 49, pika 1, shkronja h, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Udhëzimit të MASR nr. 5, datë 19. 02. 2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" gjatë mbledhjes së përbashkët me Senatin Akademik të datës 18. 10/. 2019 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë të dhënat e "Draft -Raportit të vitit akademik 2018- 2019, të veprimitarisë së Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, të hartuara nga Rektorati, konform të dhënave, informacioneve dhe vlerësimeve të përgatitura nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
2. Në këtë "Draft - Raportit të vitit akademik 2018- 2019, të veprimitarisë së UV-së", të reflektohen sygjerimet e bëra gjatë kësaj mbledhjeje dhe në vijim të dhënat të kalojë në riorganizim elektronik, gjuhësor dhe formal, pranë strukturave të ngarkuara që u vendosën në mbledhjen e përbashkët. Më mbas të vijohet me miratimin e Raportit Vjetor, në një seancë tjetër vazhdimësi e kësaj mbledhjeje.
3. Vendimi arkivohet dhe së bashku me "Raportin vjetor të veprimitarisë së UV për vitin akademik 2018-2019" (mbas plotësimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi), i dërgohet MASR dhe gjithë autoriteteve dhe organeve drejtuese kolegjiale, personelit akademik dhe strukturave ndihmës akademike të UV-së.
4. "Raporti vjetor i veprimitarisë së UV për vitin akademik 2018-2019" shpallet në WEB-in e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar